



Bordi

VENDIM

Nr. 166, Datë 19.07.2018

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E SISTEMIT TË NJEHSUAR
DHE STANDARD TË LLOGARIVE PËR TË LICENCUARIT NË
VEPRIMTARITË E TRANSMETIMIT, SHPËRNDARJES DHE FURNIZUESIT
TË SHËRBIMIT UNIVERSAL, NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE.**

Në mbështetje të neneve 16, 35 dhe 45 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e energjisë elektrike”; i ndryshuar, nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 19.07.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, mbi fillimin e procedurës për miratimin e Sistemit të njëhsuar dhe standard të llogarive për të licencuarit në veprimtaritë e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizuesit të shërbimit universal, në sektorin e energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Në zbatim të neneve 35 dhe 45 të Ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, ERE harton dhe miraton një sistem të njëhsuar dhe të standardizuar të llogarive për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, mbështetur në legjislacionin shqiptar dhe standartet e pranuar ndërkombëtare mbi kontabilitetin.
- Sistemi i njëjtë i llogarive i adoptuar nga ERE, për shoqëritë e licencuara në sektorin e energjisë elektrike, përbën strukturën e rregullave për mbajtjen e llogarive të ndara nga ana e tyre, përfshirë llogaritë e aseteve, kapitalit, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve për qëllim të llogaritjes së çmimeve dhe tarifave sipas metodologjive përkatëse dhe është përshtatur me qëllimin që të mundësohet monitorimi i veprimtarive të licencuara.
- Sistemi i kontabilitetit, i specifikuar në Sistemin uniform të llogarive do të jetë i zbatueshëm për të gjitha shoqëritë e licencuara të sektorit të energjisë elektrike,

të cilat janë të detyruara të plotësojnë kërkesat rregullatore për mbajtjen e llogarive në përputhje me Ligjin nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e sistemit të njehsuar dhe standard të llogarive për të licencuarit në veprimtaritë e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizuesit të shërbimit universal, në sektorin e energjisë elektrike.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.